

**Paga minimale
në Zvicër**
**Vendit të fortë i
duhen paga korrekte**
2
GAV-Service.ch
**Platforma e shërbimit
për Kontratat e Punës**
3
**Përmbyllja
e pagave 2014**
**Të arriturat në degë
të ndryshme ekonomike**
4
Nr. 1 | shkurt 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Votimet federale të 9 shkurtit 2014 në Zvicër

PO-ja iniciativës së SVP-së – Flakaresh për migrantët

9 shkurti 2014 u shënuar si dite e zeze në politikën zvicerane të migracionit: Iniciativa seleksionuese e Partisë Popullore të Zvicrës (SVP) u aprovua nga sovranit. Me 50,3% të votave populli zviceran votoi për eliminimin e qarkullimit të lirë të personave dhe kështu vendosi për politikën e kontingjenteve. Ky vendim paraqet një hap mbrapa sa i përket të drejtave të migrantëve.

Edhe përkundër parallogarite me një vendim me diferencë të vogël, shpresohej me refuzimin e iniciativës seleksionuese të SVP-së. Megjithatë 1 463 954 votat për ngadhënjyen kundër 1 444 428 votave jo. Ky vendim nuk d.m.th. vetëm një hap prapa sa u përket të drejtave të migrantëve, porse paraqet edhe një hap mbrapa sa i përket edhe të drejtëve të punëmarrësve. Kthimi në kontingjente d.m.th. se punëmarrësit përsëri do të jenë të varur nga punëdhënësit dhe kështu do të shfrytëzohen edhe më lehtë.

Ardhmëria e pasigurt

Iniciativa parasheh që vetëm një numër i përcaktuar i punëmarrësve, refugjatëve, azilkërkuesve dhe kaluesve të kufirit (udhëtarëve punëtorë) do të ketë të drejtën të vijën në Zvicër. Pos kësaj duhet të vlejë përparësia e zviceranëve dhe brenda tre vjetëve të ardhshme parasheh anulimin dhe negociimin e cilësdo kontratë a marrëveshje, që ndalon kontingjentet. Një marrëveshje që duhet anuluar është ajo e qarkullimit të lirë të personave. Mirëpo qarkullimi i lirë i personave është i ndërlidhur me marrëveshjet bilaterale mes BE-së dhe Zvicrës. Është e paqartë se a është dhe deri në cilën masë është e gatshme BE-ja të vijojë marrëveshjet bilaterale pa qarkullimin e lirë të personave. Deri më tani BE-ja ka bërë të qartë se pa qarkullimin e lirë të personave do të anulohen edhe marrëveshjet bilaterale.

Duhet pranuar e njohur kontributi i migrantëve

Iniciativa seleksionuese është iniciativa e fundit nga radhët e inicia-



Pamje nga aksioni me 18.12.2013, Ditës Ndërkombëtare të Migracionit, në sheshin federal të Bernës

tivave dhe politikave ksenofobe, e cila i paraqet migrantët si fajtor kujdestar. Shumë persona janë ngopur nga kjo qasje! Andaj, pas njoftimit të rezultateve votuese, me qindra njerëz janë mbledhur në protesta spontane. Posaçërisht në Bernë, Cyrih, Luzern dhe Bazel ka pasur demonstrata të mëdha. Është koha që kontributi i migrantëve në shoqërinë zvicerane të pranohet e njihet dhe të ndërpriten ngacimimet ksenofobe. Për këtë arsye ne duhet të mobilizohemi!

PO e qartë zgjerimit të infrastrukturës hekurudhore

Krahas iniciativës seleksionuese të SVP-së u votua edhe për dy propozime tjera. Propozimi për financimin dhe zgjerimin e infrastrukturës hekurudhore u aprovua me 62% të votave të popullit votues. Në kushtetutë duhet të ankorohet se mirëmbajtja dhe zgjerimi në të ardhmen duhet financuar nga një Fond. Rreth 5 miliarda franga duhet të rrjedhin për çdo vit në këtë Fond. Kështu vlerësohet meritueshëm dhe zgjerohet komunikacioni publik.

JO ndryshimit për financimin e abortimit

Populli votues zviceran pos tjerash ka vendosur që ndërprerja e shtatzënisë edhe më tej të paguhet nga arka e sigurimit shëndetësor. Rreth 70% e votuesve zviceran kanë refuzuar ndryshimet e financimit të abortimit. Edhe njëherë populli është deklaruar kundër sulmit konservativ karshi të drejtave të grave, për të vendosur vet mbi trupin e tyre.

Editorial




Në Zvicër edhe përkundër krizës ekonomike të Evropës dhe Francut të fuqishëm ekonomia e vendit do edhe këtë vit të rritet më tej. Megjithatë të djathtët dhe punëdhënësit do të shfrytëzojnë rrethanat e pasigurta evropiane të atakojnë edhe më tej Sigurimet Shoqërore dhe Ligin e Punës. Detyra jonë me këtë rast është që çështjen e shpërndarjes së drejtë dhe pagat ti vejmë në qendër të diskutimit. Andaj ne do të luftojmë që të ngiten dhe të fuqizohen pagat minimale në Zvicër. Posaçërisht e rëndësishme është data 18 maj: kur votohet për pagën minimale prej 4000 Frangave. Ne duhet ta fitojmë këtë votim dhe ne llogarisim në mbështetjen Tuaj! Kjo është një sfidë madhe të cilës duhet ti dalim përballë të bashkuar!

Edhe këtë vit Unia do të luftojë më tej për masat mbrojtëse gjithëpërfshirëse në kuadër të qarkullimit të lirë të personave dhe kundër dumpingut vrasës në paga. Në këtë kontekst na shqetëson neve posaçërisht iniciativa ksenofobe, të cilën e ka krijuar SVP-ja përmes iniciativës së migracionit masiv. Ne nuk do ti tolerojmë edhe përkeqësimet e kushteve të punës në sektorin e shitjes me pakicë dhe ato të ligjit të punës. Tema tjera të veçanta do të jenë fuqizimi i të drejtave të sindikalistëve, barazia e pagave dhe pagat për nxënësit që ndjekin arsimimin profesional. Gjithashtu këte vit do të na preokupojë fuqizimi me rastin e ripërtëritjes i KKP-ve të ndryshme, për çka na duhet të forcojmë fuqinë mobilizuese si dhe prezencën nëpër ndërmarrje, me çka sigurohet zbatimimi i KKP-ve. Fundit e vitit me rastin e 10 vjetorit të Unia-s do ta festojmë me një festë të madhe. Ne jemi një familje e madhe, me të cilën jemi krenar dhe e cila shënojë arritje të suksesshme.

Vanja Alleva e Renzo Ambrosetti
Bashkë-presidentët të Unia-s

News

MEM: Kthimi i kontributeve të solidaritetit



Anëtarët e Unia-s, të cilët vitin e kaluar kanë qenë anëtarë dhe kanë qenë të punësuar në një nga firmat kontraktuese të industrisë zvicerane të makinave (ASM/Swissmem), nga punëmarrësit do të marrin Librezën e kontributeve të solidaritetit përmes të cilit u kthehen 200 Franga. Në rast të problemeve për këtë çështje drejtohuni menjëherë tek sekretariati përgjegjës të regjionit Tënd të Unia-s. Luteni që të tërhiqni librezën më së largu deri më 31.12.2014!

Unia: Sindikata jonë rritet më tej

Unia në vitin 2013 është rritur përsëri. Në fund të vitit 2013 ka numëruar 199 453 anëtarë. Janë 3495 më shumë se sa në fund të vitit 2012 (plus 1,8%). Posaçërisht rritje Unia ka shënuar në sektorin e shërbimeve (plus 4,54%) dhe në zejtarin (+3,1%). Ne ju falënderojmë përzemësisht për angazhimin e juaj të përditshëm – falë jush ne në një të ardhme të afërt do të arrijmë të shënojmë markën 200 000-she!

Bosch Scintilla AG: Pajtim i përkohshëm i konfliktit

Në mbledhjen e punëtorëve të ndërmarrjes më 21 janar të 368 punonjësit pjesëmarrës aprovuan paketën e negociuar për zgjidhjen e problemeve në mes të drejtorisë së koncernit Bosch dhe Unia-s. Pikat kryesore të kësaj marrëveshjeje: Zgjatja e afatit konsultues deri në fund të marsit, shqyrtimi i mundësive të ruajtjes së vendeve të punës përmes mandatimit të një instituti të pavarur të biznesit, garantimin e mos pushimit nga puna deri më 1 prill 2015.

Konferenca e sektorit të përkujdesjes: në ekonomitë familjare

Më 24 janar u mbajt konferenca e sindikatës Unia «Kujdesi në ekonomitë familjare». Delegatët u treguan të kënaqur me përparimeve të arritura me rastin e bisedimeve për një Kontratë Kolektive Pune me Shoqatën e punëdhënësve «Jeta në shtëpi». Në të njëjtën kohë ata shprehën brengosjen për zgjerimin e dumpingut në paga të këtij sektori dhe veçanërisht për «Kontratën bazike» të Organizatave SpiteX në Bazel. Ky i hap dumpingut në paga dyer e dritare. Nëse nuk anulohet kontrata deh nëse nuk negociohet një KKP me kushte të mira pune, Unia do të ndërmarr me të gjitha masat kundër punëdhënësve shfrytëzues.

Ndryshimet në Sigurimet Shoqërore 2014

Pak ndryshime tek Sigurimet Shoqërore

Këtë vit ndryshimet kufizohen në rrafshin e kompensimit dhe kontributit në rast papunësie.


Kontributet në Arkat e papunësisë

Shkalla e kontributit në Sigurimin e Papunësisë (ALV/AC) për pagën vjetore prej 126000 Frangave përbënë 2,2%. Për pagat më të larta vjetore deri në 315000 Franga shkalla e kontributit është 1%, ndërsa tek pagat vjetore mbi 315000 punëmarrësit lirohen nga pagesa. Risi me këtë rast është se edhe ata me pagë të lartë paguajnë kontributin e solidaritetit prej 1%.

Kompensimi i premive

Rishtas kompensimi i premive do tu paguhet Arkave të Shëndetësisë drejtpërdrejt. Nga ana e tyre Arkat shëndetësore do të heqin kompensimet direkt nga premitë. Kush merr të ardhura suplementare kompensimi i premisë do ti përlogaritet si shumë paushall (premitë mesatare kantonale apo regionale) tek daljet e të ardhurave suplementare. Kjo shumë paushall gjithashtu do tu paguhet drejtpërsëdrejti Arkave shëndetësore. Harxhimet tjera për Arkën shëndetësore i ngarkohen direkt të siguruarit nga ana e Arkës shëndetësore.

Paga bruto	Punëdhënësi	Punëmarrësi	Totali
Kontributi në pagën vjetore deri më 126000.00 CHF	1.1 %	1.1 %	2.2 %
Kontributi në pagën vjetore mbi 126000.00 CHF (rishtas pa kufizimin i artas)	0.5 %	0.5 %	1.0 %



Kontrolloje të drejtën tënde për kompensim premish

Kushdo që ka kontraktuar një Sigurim obligues shëndetësor dhe që jeton në rrethana modeste ekonomike, mund të kontrollojë të drejtën për kompensim të premisë. Secili Kanton e ka të përcaktuar, se cilat parakushte

duhet plotësuar. Informohuni tek selia e Kantonit Tuaj. Sipas rregullit për kompensimin e premive përgjegjës janë Entet Sociale. Adresën e gjeni tek rubrika «Dienstleistungen der AHV/AVS» në Web-faqen <http://www.ahv-iv.info>.

Aurora Garcia

Iniciativa për pagën minimale

Vend i fortë – Paga korrekte: Për pagën minimale!



Pamje nga aksioni specifik për pagë minimale i sindikalistëve zviceran

18 maji të gjithë punëmarrësve mund tu bie përparim të madh: Atë datë do të votohet për iniciativën e sindikatave «Për më shumë mbrojtje të pagave korrekte», thënë shkurt do të votohet për pagë minimale dhe kështu për fuqizimin e pagës mujore 4000 frangash të garantuar me ligj, e cila do të zbatohet brenda tre vjetëve pas votimit aprovues. Kampanja parasheh shumë aksione ditore e javore. 8 marsi, dita ndërkombëtare e grave do të jetë dita e aksionit të parë të madh të kampanjës votuese. Por, për cilat arsye angazhohemi ne për pagën minimale të garantuar me ligj?

E drejta për pagë korrekte

Edhe pse Zvicra është në vend pasur, në fakt punojnë 330000 njerëz për një pagë nën 22 Franga orën. Këta janë rreth 9% të punëmarrësve në Zvicër. Kjo nuk është në rregull, pasi gjithsecili do të duhet të kishte të drejtën, për të bërë jetë korrekte me pagën e tij. Argumenti se paga e njëjtë minimale për secilin regjion është e pakuptimtë, pasi shembulli bie në Cyrih jeta është më e shtrenjtë se sa në Lugano, nuk qëndron. Sepse, ed-

he pse është e vërtetë se shumëçka në Cyrih është më shtrenjtë, por taksat telefonike e televizive, apo medikamentet dhe artikujt bazik ushqimor në Tiçino janë njëjtë shtrenjtë sikur në Cyrih! Iniciativa nuk ka për qëllim të zëvendësojë Kontratën Kolektive të Punës (GAV-CCT), porse të përcaktojë kufirin e pagës më të ultë për të gjithë, e i cili ka kuptim për të gjithë. Kjo gjithsesi ka mundësi të zbatohet në Zvicër, pasi që Zvicra ka para të mjaftueshme.

Pagë korrekte për të gjithë

Nuk është në rregull që disa menaxherë të fitojnë shuma enorme, derisa të tjerët edhe përkundër punës së plotë nuk fitojnë mjaft për të jetuar! Shumica e 330000 vetave, përkundër opinionit që zakonisht mbretëron, nuk janë të pakualifikuar. Rreth 33% të këtyre punëmarrësve posedojnë diplomë profesionale! Pra fjala është për njerëz me arsimim të mirë, të cilët megjithatë nuk fitojnë mjaftueshëm. Ky është në nënçmim i arsimimit profesional dhe dumping i përhapur në paga.

Paga minimale si mbrojtje pagash

Derisa jemi tek dumpingu në paga: Nga pagat e ulëta posaçërisht janë të prekura sektorët si ai i industrisë së orëve apo tregtisë me këpucë. Se dumpingu në paga është shumë i përhapur në sektorin e shitjes me pakicë dhe të shitjes të veshmbathjeve, e ka vërtetuar edhe komisioni trepalësh i federatës në fund të vitit që lamë pas. Këta janë sektorë, të cilët posedojnë pak Kontrata Kolektive Pune (KKP), e në të cilat punëdhënësit edhe më tej refuzojnë të përmblyllin KKP-të. Paga minimale do të ishte hapi i parë për kushte më të mira pune dhe një mbrojtje e mirë nga dumpingu në paga.

Shumë gra në sektorët me paga të ulëta

Nga 330000 personat, të cilët punojnë për më pak se 22 Franga në orë, rreth 70%, pra 220000 janë gra. Sa më e lartë përqindja e grave në një sektor, po aq është edhe përqindja e pagave të ulëta. «Punë tipike për gra», janë sektorët si ai i pastr-

mit ose ai i tregtisë me pakicë, dhe vlerësohet më pak në krahasim me «punët tipike për burra», ndaj edhe paguhet më keq. Padrejtësisht, pasi profesionet e grave janë profesione të mira dhe meritojnë njohje – edhe financiare!

Aksionet më 8 mars

Aktivitetet me rastin e ditës ndërkombëtare të grave, 8 marsit, kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen. Me këtë datë Unia do të jetë prezent jo vetëm nëpër rrugë ku do bëjë sensibilizimin mbi iniciativën për pagën minimale dhe përparësitë që ajo bie, por me anëtarët e saj aktiv do të jetë prezent edhe nëpër ndërmarrje, sikur që ka qenë në vitet e fundit në sektorin e industrisë së orëve. Me këtë rast do të shpërndahen Fletëpalosje dhe 4000 (arinj të vegjël) «të ëmbël». Të gjithë janë të ftuar, edhe Ti, të jenë aktiv këtë ditë aksioni!

Aurora Garcia



18. Mai 2014

Jo vetëm më 8 mars, por posaçërisht në muajin prill janë planifikuar dhe do të realizohen shumë aksione. Ne të gjithë jemi të sfiduar, andaj luteni te "na bashkohesh edhe Ti! Informo-hu tek sekretariati më i afërt i Unia-s se si mund ti kontribuosh aktivisht kampanjës edhe Ti.

GAV-Service.ch - Platforma e shërbimit për KKP-të

GAV-Service.ch: Instrument në luftë kundër kushteve të këqija të punës

Faqja e internetit www.gav-service.ch, e cila është realizuar nga sindikata Unia, që nga fundi i vitit 2010 u ofron përdoruesve pa pagesë qasje në Kontratave Kolektive të Punës dhe në llogaritësin e pagave. Bashkë-presidentja e Unia-s, Vanja Alleva, tri vite që nga fillimi i platformës, vlerëson pozitivisht rezultatin e kësaj faqeje të veçantë të internetit.

Unia ka startuar para tri vitesh me platformën GAV-service.ch. Cilën rezultat nxjerr ti nga këto tri vite?

Rezultati është shumë pozitiv. Tri vite nga fillimi i platformës GAV-Service.ch arsyeton rolin e funksionin si bazë e të dhënave të informacionit për Kontratave të Punës (rreth 200 sosh), në shumicën e të cilave Unia është partner social. Rritja në vazhdimësi e vizitorëve dhe përdoruesve nuk është vetëm një tregues shembullor i suksesit, por edhe i rëndësisë që ka brenda këtyre tri viteve numri mi vizitorëve është dyfishuar, gjegjësisht nga 600000 vizitorë në muaj në fund të vitit 2010 deri në 1 200000 vizitorë në muaj në fund të vitit 2013.

Në fillim të vitit 2013 platforma u prezantua me një pamje të re. Cilat ishin risitë dhe për cilat arsye u importua kjo pamje?

Qëllimi ynë kryesor ishte tu ofrojmë qasje më të mirë në informata punëmarrësve në lidhje me KKP-të, të cilave ata u nënshtrohen dhe ti zgjerojmë informatat për to. Për këto arsye ne kemi thjeshtëzuar përdorimin e faqes së internetit dhe kështu kemi mundësuar një qasje më të shpejtë tek të dhënat informative. Për këtë lehtësim kemi prodhuar një video si dhe një dokument të shkurtër mbi shërbimin e KKP-ve shkurtimisht, një lloj udhërrëfyese e përdoruesi i thjeshtëzuar i faqes së internetit. Ne kemi edhe risi teknike si profilin ushqyes (RSS-Feed), i cili u mundëson vizitorëve të jenë rrjedhë të risive të faqes së internetit si dhe të qasjes në informata.

Në fund të vitit 2013 gjithashtu është thjeshtëzuar kërkimi i fjalëve



Bashkë-presidentja e intervistuar e Unia-s, Vanja Alleva

GAV-Service.ch

Marrëveshjet kolektive zvicerane online

Informohu për të drejtat e tua!

www.gav-service.ch

Pamje nga broshura në gjuhën shqipe mbi shërbimet e GAV-Service.ch

kyçe. A janë planifikuar përmirësimet tjera në vitin 2014?

Kjo qëndron, kërkimi i fjalëve kyçe është përmirësuar. Tani rezultati i përgjigjet saktësisht kërkimit përmes fjalëve kyçe. Këtë vit ne do të prezantojmë edhe një ndryshim tjetër të rëndësishëm: rishtas në GAV-Service.ch do të mundësohet që krahas pagës minimale të përlllogaritën edhe pagat që vlejën nëpër regjione për rreth 70 degë ekonomike. Ky llogaritës pagash për përlllogaritjen e pagave të vlefshme për bizneset lokale është zhvilluar me mandat të Unionit të Sindikatave Zvicerane (SGB) nga Observatoire Universitaire de l'Emploi (OUE) të Universitetit të Gjenevës në bashkëpunim me Observatoire genevois du marché du travail (OGMT). Kuptimi dhe qëllimi i llogaritësit të pagës është posedimi edhe i një instrumenti në luftë kundër keqpërdorimeve të

kushteve të punës dhe posaçërisht kundër dumpingut në paga.

A mund të na shpjegosh se si paraqet platforma GAV-Service.ch një instrument në luftë kundër kushteve të pasigurta të punës?

Platforma u ofron punëmarrësve në Zvicër mundësinë të marrin informata të qarta dhe aktuale mbi Kontrata e Përgjithshme të Punës, me të cilat ata kanë të bëjnë. Duke ua vu në dispozicion këtë informacion punëtoreve dhe punëtorëve e bënë atë një instrument specifik dhe eficient në luftë kundër kushteve të pasigurta të punës dhe kundër dumpingut në paga. Një punëmarrës, i cili është i informuar mirë mbi të drejtat e tij mund të kundërshtoj punëdhënësin e paskrupull dhe të painformuar mirë. Pra kush është mirë i informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tija, mund ta vlerësojë më mirë se ku qëndron ekuilibri i drejtë mes punëdhënësit dhe punëmarrësit. Dhe sa më shumë punëmarrës të një ndërmarrjeje i kuptojnë të drejtat e tyre, aq më e vështirë bëhet për një punëdhënës që të injorojë kërkesat e punëtorëve. Unia mbështet punëmarrësit në synimet e tyre për tu bashkuar dhe për të vepruar bashkërisht. Përderisa Unia përfaqëson punëmarrësit në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe të negociatave të ndërmarrjes, e ka për detyrë të sigurojë kushtet e punëmarrësve dhe të realizojë kërkesat e përbashkëta, nga të cilat përfitojnë të gjithë dhe të cilat perceptohen nga të gjithë.

Platforma GAV-Service.ch paraqet një mjet të shkëlqyeshëm pune për ti përmirësuar kushtet e punës për punëmarrësit. Cilat janë rrugët dhe mjetet për të bërë më të njohur platformën?

Punëmarrësit mund të shfrytëzojnë platformën e GAV-Service.ch përmes çdo lloj kompjuteri, tablete apo te-

lefoni mobil që ka qasje interneti. Faqja e internetit është në tri gjuhët zyrtare të Zvicrës: Gjermanisht, frëngjisht dhe italisht. Gjithashtu është e mundshme të shkarkohen informatat poseduese në versionin PDF, si dhe për ti printuar ato, apo për ti dërguar më tej përmes postës elektronike. Kush dëshirojë që t'ia bëjë të njohur rrethit të vet faqen e internetit mund ta bëjë këtë duke iu drejtuar sekretariatit të vet të Unia-s për fletëpalosje, të cilat përmbajnë informata në të tri gjuhët e vendit. Pos tjerash posedohen kartolina në gjuhët e vendit

si dhe në gjuhën shqipe, portugeze, spanjolle, e serbokroate.

Madalena Bortnik

Nëse ke pyetje për një KKP të caktuar apo në lidhje me funksionimin e shërbimeve të GAV-Service.ch dërgo një E.mail në gav-service@unia.ch

Platforma e shërbimeve të GAV-Service.ch

Sindikata Unia është partnere sociale e rreth 270 Kontratave Kolektive të Punës dhe ofron një shërbim specifik mbi KKP-të. Shërbimi në fjalë përfshinë të dhënat kryesore të KKP-ve kryesore: Ky shërbim ofron në pyetjet e shtruara përgjigje të shpejta dhe konkrete si dhe ju mundëson

- përmes fjalëve kyçe të kërkoni KKP-të e degëve të bizneseve të ndryshme ekonomike;
- të gjeni detaje të përzgjedhura të KKP-ve (shembulli bie për pushimet vjetore);
- pagesën minimale të orëve të punës (përfshirë edhe pushimet dhe shtesat për ditët e festave, si dhe eventualisht edhe përlllogaritjen e pjesës mujore të pagës së 13-të)

Pos kësaj në dispozicion për shkarkim janë edhe dokumente origjinale të KKP-ve si dhe vegë tjera të dobishme interneti.

Fjala është për informata mbi pagat dhe të dhëna, të cilat nuk asnjë rast nuk duhet anashkaluar. Nëse ndodh një gjë e tillë, atëherë ne ju këshillojmë të lidheni me sekretariatit e Unia-s të regjionit tuaj.

Cilat informata mund ti gjej dhe si?

Krahas llogaritësit të pagës minimale faqja e internetit posedon posaçërisht rregullat e veçanta të rreth 200 KKP-ve. Përmes detajeve të KKP-ve (GAV-Details) vizitori i faqes së internetit ka mundësi që dispozitat të përmbledh si tekst. Në përgjithësi janë rreth 50 kriteret, të cilat mundësojnë një pasqyrim me të mirë dhe të rregulluar të grupeve tematike (KKP-të e përmbledhura, kushtet e punës dhe partneriteti social). Këto grupe janë të ndara edhe njëherë në 4-7 nëngrupe. Këtu janë të pasqyruara temat si «pushimet», «pagesat shtesë», «koha e punës», «kontributet», apo mbrojtja në punë dhe mbrojtja nga diskriminimi.

Përmbyllja e pagave 2014

Të arriturat në degë e caktuara ekonomike

Sektorët	Firmat	rritjet	Rritjet e përgjithshme	Rritjet individuale	Vërejtjet shtesë
Industria e MEM	Amtcor, Rorschach (SG)	2%	-	2%	
	Bombardier Transport, Villeneuve (VD)	1,5%	-	1,5%	
	Sapal (Bosch Packaging)	0,5%	-	0,5%	Plus premia prej 0,7% (Fr. 850.- deri 1400.-)
	Schindler, Ebikon (LU)	0,6%	-	0,6%	
	UIG, Ginebra	2,5%	-	2,5%	Rritje e pagës minimale
	Siemens	1,8% për 2/3 të punëtorëve	Fr. 100.- prej 1.4.2014/2015		
	Wago, Domdidier (FR)	1,5%	1,5%	-	Përgjithësisht Fr. 30.- apo 1,5%: Pagë minimale Fr. 4000.-
Industria e Ndërtimit	Ndërtimtaria kryesore	1,2%	0,4%	0,4%	Kompensimi për drekë rritet nga 14.- në 15.- Franga
	Industria e tullave CH	-	Fr. 50.- për të gjithë të punësuarit me orar të plotë	-	
Kimia	CABB, Pratteln BL	1,35%	-	1,35%	
	Cilag, Schaffhausen	1,5%	-	1,5%	
	Johnson Controls	1,2%	-	1,2%	
	Roche	1,7%	70.-		
	SI Group Pratteln (BL)	1,2%	1,2%	-	
	Syngenta	1%	-	1%	Oferta është refuzuar
Industria ushqimore dhe ajo shijuese	Camille Bloch, Courtelary BE	1,5%	1,5%	-	
	Feldschlösschen, Rheinfelden AG	-	-	0,9%	0,9% individualisht, nga të cilat shuma bazë Fr. 30.- për pagat deri Fr 5000.- dhe Fr. 20.- për pagat nga Fr. 5000.-
	Fenaco	0,8%	-	0,8%	Unia ka refuzuar ofertën
	Lindt & Sprüngli, Kilchberg ZH	-	-	1,5% deri tek paga minim. Fr. 5000.- 1% për paga mbi Fr. 5000.-	
	Salines de Bex (VD)		30.-		Pagesa e një premia prej Fr. 2000.- në dhjetor 2013 dhe një tjetër në maj 2014 prej rreth Fr. 1500.-
	Fabrikat e sheqerit	0,7%	-	0,7%	
Ekonomi ndërtimi dhe zejtar	Zeja e karrocerve (limar)		40.- Fr. (deri 5800.-)	-	
	Tavanpunues dhe ndërtim sistemesh të brendshme		40.-/në muaj	30.-	40.-/në muaj përgjatë 3 vjetëve, 2014 kufiri tek 6751.-
	Elektricitetë/telekomunikim/zeje instaluese	-	30.-/në muaj	1,5%	
	Industria e drurit	1,3-1,44%	1,3-1,44%	-	
	Zeja izoluese		50.- (Plafonimi tek paga minimale 5800.-)		
	Zeja e përpunimit të metaleve		50.-		
	Shtrim pllakash		40.-	-	
Terciar	Zeja e zdrukthetarisë		50.-		
	Coop	-	-	1%	Oferta është refuzuar
	Berber CH	-	-	-	Ngritje e pagave minimale për 6%
	Elvetino	-	-	-	Ngritje e pagave minimale 0,7%
	Gastronimi	-	-	-	Ngritje e pagave minimale 0,2%
	Pastrimi në Zvicrën gjermane				Ngritje e pagave minimale 2,5%
Sektor i sigurimit				ANgritje e pagave minimale 10-20%	

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Zbritjet:

A duhet pensionistët që vazhdojnë të punojnë të paguajnë kontributet në sigurimet sociale

Unë shpejt do të mbushi 65 vjet dhe jam duke marrë pension të pleqërisë dhe atë profesional. Me dëshirë do të punoja më tej pjesërisht edhe pas pensionimit tim. A do të duhej unë në një rast të tillë të paguaja edhe më tej kontribute në arkën e sigurimit të pensionit të pleqërisë (AHV/AVS)? Me cilat zbritje tjera nga paga duhet të llogaris?

Po, ju duhet të paguani më tej. Detyrimi për të paguar kontribute në AHV/EO nuk përfundon me marrjen e pensionit të pleqërisë (AHV). Me rastrin e marrëdhënies në punë Firma është detyruar që me rastin e një page mujore që kalon shumë 1400 Franga apo në vit 16800 Franga (shumë e lejuar për çdo punësim), ti zbrisë kontributet e sigurimeve nga kolona e parë AHV/IV/EO dhe t'ia paguajë ato arkës përgjegjëse të fondit kompensimit AHV/AVS. E njëjta vlen edhe për sigurimin aksidental (UVG). Sigurimi aksidental (UVG) nuk njeh limit moshe. Andaj është e lejuar që edhe më tej të zbriten nga paga kontributet për sigurimin e detyrueshëm aksidental. Premitë orientohen sipas të ardhurave të siguruar. Në të kundërtën me arrijtjen e moshës së pensionit të rregullt të pleqërisë nuk duhet paguar kontributet në arkën e sigurimit të papunësisë si dhe në fondin e sigurimit profesional. Se a jeni të siguruar pas moshës 65 vjeç për parat ditore në rast sëmundjeje, varet nga kushtet e përgjithshme të sigurimit të arkës së sigurimit shëndetësor, të cilën e ka kontraktuar firma juaj. Varësisht nga kushtet mbulesa juaj e sigurimit përfundon me arrijtjen e moshës 65 vjeç. Mirëpo mund të ndodh që ju mbeteni edhe më tej të siguruar, porse edhe përkundër pagesës së plotë të premisë në rast konkret të merrni vetëm pagesën e detyruar të ndërmarrjes bazuar në Nenit 324 të së drejtës obliguese (OR).

Alice Maridor, work, 5.12.2013

Mbarimi i marrëdhënies së punës: A është për punonjësit e moshuar në ndërtimtarin afati i prishjes së kontratës së punës më i gjatë?

Unë jam murator, 56 vjeçar dhe punoj që 13 vjet në ndërmarrjen e njëjtë. Në muajt e fundit klima e punës është përkeqësuar së tepërmi. Më 3 janar të këtij viti punëdhënësi – jo edhe krejtësisht papritur – ma ka dërguar shkresën me të cilën e prish kontratën e punës. Shkresa në fjalë është dërgua me datën 31 dhjetor 2013. Në shkresë qëndron se marrëdhënia e punës për mua përfundon me 31 mars 2014. A mund të ndërmarr unë diç kundër?

Po, gjithsesi ju mund të ndërmerrni diçka. Shefi juaj ka anashkaluar afatin e prishjes së kontratës së punës. Kontrata Vendore e Punës (LMV) për ndërtimtarin kryesore zvicerane, i ashtuquajturit LMV 2012-2015, ka zgjeruar mbrojtjen e largimit nga puna për punonjësit e vjetër. Për punëdhënësit, të cilët kanë mbush 55 vjet, afati i prishjes së kontratës nga viti i 10-të i stazhit të punës është 6 muaj. Vendimtare nuk është data e dërgimit të shkresës dorëheqëse, porse data kur ju e keni marr shkresën. Afati 6 muaj në rastin e juaj nuk fillon kurrsesi më 1 janar 2014, porse tek nga q1 shkurti 2014 dhe kështu ai përfundon më 31 korrik 2014.

Peter Schmid, work, 24.1.2014

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariaslan, M. Martín, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osmani.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.